



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KËSHILLI KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI

PROCESVERBAL

Mbajtur më 26 shtator 2019, në mbledhjen e katërt (4) të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi

Mbledhja u mbajt në sallën nr. 31 dhe filloi në orën 10.00

Në mungesë të Kryetarit të Komunës z. Agim Veliu, mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z. Nexhmi Rudari, Nënkyetar i Komunës.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm: z. Bekim Zogiani, Komandant i Stacionit të Policisë; z. Osman Kurtolli, përfaqësues i Këshillit të Bashkësisë Islame; z. Enver Rama, përfaqësues i komunitetit rom; znj. Albina Avdiu, kryesuese e komitetit për Komunitete; znj. Naime Podvorica, zyrtare për Barazi Gjinore; z. Agim Blakçori, drejtor i Drejtorisë së Arsimit; z. Naim Bajraktari, kapiten, përfaqësues i FSK-së; z. Qefser Behrami, përfaqësues i Këshillit Lokal për Siguri Publike-Kërpimëh; z. Nuhi Selimi, përfaqësues i Këshillit Lokal për Siguri Publike-Orllan; z. Rizah Muçolli, kryesues i Ekipit Veprues për Siguri në Bashkësi, z. Faik Muçiqi, përfaqësues i emergjencave civile; z. Liman Zeqiri, përfaqësues i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim dhe znj. Donjetë Sheqiri, përfaqësuese e OJQ-ve, mediave lokale, komunitetit të biznesit dhe komunitetit të personave me nevoja të veçanta.

Ndërsa mungoi: dhe z. Radisav Perović, përfaqësues i Komunitetit serb.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe: Përfaqësuesi i KFOR-it; z. Vezir Januzi, Drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural; z. Zaim Thaçi, Drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe z. Skender Shatri – OSBE.

z. Nexhmi Rudari, Nënkyetar i Komunës, përshëndetje të gjithëve, pasi që Kryetari i Komunës për shkak të angazhimeve nuk mund të marr pjesë, ne do të fillojmë me mbledhjen e KKSB-së. Në takim kemi edhe znj. Albina Avdiu, kryesuese e komitetit për Komunitete, e cila do të jetë anëtare e Këshillit, pozitë kjo e cila parashihet me Udhëzimin Administrativ përkatës dhe që ka kaluar edhe përmes Kuvendit të Komunës, i dëshirojmë mirëseardhje dhe punë të mbarë. Materialet konsideroj se i keni marrë të gjithë, a ka ndonjë vërejtje apo plotësim lidhur me rendin e ditës.

Rendi i Ditës
U miratua njëzëri.

- 1. Shqyrtimi dhe miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 26 qershor 2019**
U miratua njëzëri

2. Raporti i Policisë së Kosovës për gjendjen e sigurisë në komunë
 - Informatë nga përfaqësuesi i KFOR-i për sigurinë në komunë
 - Informatë nga përfaqësuesi i FSK-së për sigurinë në komunë

z. Nexhmi Rudari, Nënkyetar i Komunës, fillimisht fjalën e ka Komandanti i Stacionit të Policisë, pastaj vazhdojmë me informatat që do të japin përfaqësuesi i KFOR-it dhe ai i FSK-së.

z. Bekim Zogiani, theksoi, situata e gjendjes së sigurisë vlerësohet e qetë dhe stabile, nuk ka ndonjë informacion për tendenca të prishjes së rendit dhe qetësisë publike në përmasa të mëdha. Raste të zakonshme krahasuar me periudhën e njëjtë vitit të kaluar kemi 25 % më pak. Në periudhën korrik-gusht dhe këtë pjesë të muajit shtator të vitit të kaluar kanë qenë 322 raste të evidentuar, ndërsa në periudhën e njëjtë të këtij viti 258 raste. Prej rasteve më shqetësuese janë rastet e dhunës në familje, ku krahasuar me periudhën e vitit të kaluar ka ngritje bukur të madhe të këtyre rasteve. Vitin e kaluar, për periudhën e njëjtë kanë qenë të evidentuara 34 raste, ndërsa tani në të njëjtën periudhë janë 60 raste. Faktorët të cilët po ndikojnë në këtë kategori të veprave penale janë persona me probleme mendore, kushtet e dobëta ekonomike, etj. Sikurse jeni në dijeni, më 25 shtator ka filluar fushata parazgjedhore dhe Policia ka një rol të veçantë në monitorimin e kësaj fushate. Sipas vlerësimit gjithçka është duke shkuar në rregull pa ndonjë problem të evidentuar, po ashtu jemi duke përgatitur edhe planin operativ për ditën e zgjedhjeve dhe pas zgjedhjeve. Sa për njoftim, kemi pranuar 17 zyrtarë të ri policorë të cilët janë sistemuar në Stacionin Policor në Podujevës, gjë që ka ndikuar dhe është relaksuar pak mungesa e zyrtarëve, detyrat më lehtë po realizohen.

Përfaqësuesi i KFOR-it, theksoi, jemi një ekip i ri, ka dhjetë ditë që kemi ardhur dhe do të qëndrojmë këtu 6 muajt e ardhshëm. Jemi duke u përgatitur për vëzhgimin e fushatës parazgjedhore, për monitorimin e tubimeve të mëdha por edhe për ditën e zgjedhjeve, pra jemi në suazën e përgatitjeve tona.

z. Nexhmi Rudari, Nënkyetar i Komunës, në emër të kolegëve ekipit të sapoardhur të KFOR-it u dëshiroj punë të mbarë.

z. Naim Bajraktari, theksoi, ne si FSK, përgjithësisht vlerësojmë se situata është e qetë dhe vazhdon të jetë e qetë, pa indikacione të destabilizimit. Gjatë periudhës verore kemi pas disa intervenime sa i përket aspekteve të sigurisë, njëri ka të bëjë me kërkim shpëtim në ujëra që ka ndodhë në liqenin e Batllavës në muajin gusht, ndërsa operacioni tjetër, është aktiviteti ku Njësitet tona të specializuara të deminimit kanë bërë pastrimin e mjeteve të pashpërthyer në fshatin Lupç.

z. Nexhmi Rudari Nënkyetar i Komunës, e hap diskutimin për këtë pikë.

z. Qefser Behrami, theksoi, kemi një situatë ku një familjeje ka filluar të preket nga një sëmundje psikike. Një person me të meta mentale nga ajo familje është duke shfaqur shenja agresiviteti dhe po paraqet rrezikshmëri për banorët. Duhet të ndërmerret diçka ndaj asaj familjeje, pikërisht ndaj atij personi, përndryshe mund të ketë pasoja, pra pritët rrezikshmëri nga ai person sepse mund t'i sulmojë fëmijët gjatë gravitimit për në shkollë. Ai duhet të dërgohet në ndonjë qendër rehabilituese. Gjithashtu dua të potencoj problemin e qeneve endacak, sepse paraqesin rrezikshmëri të madhe, kemi raste të sulmimit të fëmijëve.

Në shkollën e fshatit Kërpimeh duke ju falënderuar një donacioni dhe disa bashkëfshatarëve kemi siguruar ujin, por jo të pijes, vetëm për pastrim. Gjithashtu falënderoj OSBE-në dhe Ambasadën Norvegjeze për implementimin e sistemit të kamerave dhe digjitalizimit në shkollën e fshatit Kërpimeh.

z. Zaim Thaçi, për çështjen e të sëmurëve mental të ngritur nga parafolësi, mendoj se nuk duhet ngarkuar Policinë e Kosovës për të bërë zgjidhje por vetëm për asistim, por rastet duhet lajmëruar në institucionin më të afërt shëndetësor ku edhe duhet të filloj një organizim për trajtimin e tyre, apo të personit në fjalë. Është edhe një institucion tjetër Qendra e Shëndetit Mendor në Podujevë që nuk është në kompetencë të Komunës, institucion i cili posedon ekipin përkatës të specializuar. Në këtë aspekt duhet sinkronizuar veprimet Qendra për Punë Sociale, Qendra e Shëndetit Mendor por edhe Drejtoria e Shëndetësisë për të bërë një zgjidhje afatgjate.

z. Qefser Behrami, e kuptoj se rasti i të sëmurit mental nuk është çështje e Policisë, mirëpo ambulanta në fshatin Kërpimeh është në dijeni për personin në fjalë. Unë jam përfaqësues i atyre fshatrave dhe vërejtjet e banorëve kam për detyrë t'i paraqes në Këshill. Çështja është si mund ta zgjidhim këtë problem.

z. Nexhmi Rudari, Nënkyetar i Komunës, sa i përket çështjes së ngritur, kjo ndikon në gjendjen e sigurisë në Komunë. Policia është e obliguar të veproj dhe të intervenojë në secilin rast ku prishet rendi dhe siguria publike, megjithatë te rastet e personave me aftësi të kufizuara kjo është një hallkë e zinxhirit institucional sikurse i përmendi Dr. Zaim Thaçi. Policia nuk mund të mbajë një person të tillë me sëmundje mendore pa një vendim të prokurorit dhe në momentin e parë prokurori e liron sepse e din që ai është i papërgjegjshëm. Është një shqetësim dhe problem i madh jo vetëm në Komunën e Podujevës por në tërë Kosovën sepse institucionet që do duhej të merreshin me trajtimin e këtyre personave janë të pakta dhe kanë mungesë edhe të stafit. Ne e dimë se në gjithë Kosovën ekziston vetëm një qendër në Komunën e Shtimes. E dimë se pas luftës ka pasur njerëz me probleme të ndryshme mendore. Do doja të theksoj edhe një çështje, pak a shumë edhe ambienti që po krijojmë ne po bën agresiv këtë kategori të personave, ende në kulturën tonë nuk dimë t'i trajtojmë këta njerëz si pjesë e shoqërisë dhe mendoj se roli i institucioneve arsimore do duhej të jetë shumë më i madh.

Gjendje shqetësuese dhe problematike po ashtu kemi me qentë endacak, por sigurisht që jeni në dijeni me legjislacionin në fuqi që i referohen kësaj çështjeje dhe ne jemi të detyruar t'i zbatojmë. Ne si Komunë nuk mund të marrim iniciativa për eliminimin e tyre sikurse kemi vepruar në vitet e pasluftës. Neve si Komunë nuk na është ndarë buxhet për trajtimin e tyre, e që besoj as Komunave tjera. Është tejet e kushtueshme mbajtja dhe mbikëqyrja e një qeni endacak, pra problemi është edhe i organizimit por edhe i financimit. Nënkyetari foli gjithashtu për numrin e rasteve të dhunës në familje. Nënvizoi, jemi të shqetësuar për shtimin e numrit të rasteve të dhunës në familje, ndoshta në anën tjetër edhe duhet të ndihemi pak a shumë më mirë për arsye se dhuna në familje nuk po fshihet por po raportohen. Nuk mendoj se ka shtim të numrit të rasteve të dhunës në familje por ka shtim të raportimeve, familjet janë vetëdijesuar. Nëse nuk keni diçka për të shtuar kalojmë në pikën e radhës.

3. Propozim Plani operativ lokal (2019-2020) sipas Strategjisë për parandalimin ekstremizmit të dhunshëm që shpie në terrorizëm (2015-2020)

z. Nexhmi Rudari Nënkyetar i Komunës, fillimisht fjalën e ka Drejtori i Drejtorisë së Arsimit z. Agim Blakçori, që është një prej anëtarëve të grupit punues për përgatitjen e draftit.

z. Agim Blakçori, theksoi, në funksion të zbatimit të Strategjisë për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm që shpie në terrorizëm (2015-2020) ne si grup punues kemi zhvilluar punëtori për hartimin e draftit. Drafti është hartuar mbi bazën e një Plani të mëparshëm operativ që e kemi pasur për periudhën 2016-2018. Mbi bazën e objektivave

sipas Strategjisë kemi bërë përpjekje që të përfshijmë në plan një mori të veprimeve dhe masave duke planifikuar edhe personat përgjegjës për realizimin e veprimeve, do të përpiqemi për identifikimin e institucioneve tjera që do të mbështesin në arritjen e këtyre objektivave, si dhe periudhën kohore të planifikuar se kur do të realizohen. Propozoj mbështetjen e Planit pas korigjimit të disa lëshimeve teknike që janë bërë gjatë procesit të hartimit.

z. Nexhmi Rudari, Nënkyetar i Komunës, falënderoj Ekipin për përgatitjen e draftit të Planit, një punë të mirë që ka bërë, a ka dikush ndonjë propozim apo sugjerim. Drafti siç shihet ka objektiva të caktuara me aktivitete konkrete dhe bartësit e aktiviteteve si dhe periudha kohore për zhvillimin e aktiviteteve. Nëse nuk ka dikush diçka për të shtuar, e hedh në votim propozim Planin.

Konstatim: Pas votimit njëzëri u miratua;

Plani operativ lokal (2019-2020) sipas Strategjisë për parandalimin ekstremizmit të dhunshëm që shpie në terrorizëm (2015-2020)

4. Informatë për gjendjen e pyjeve

z. Nexhmi Rudari, Nënkyetar i Komunës, për këtë pikë fillimisht fjalën e ka Drejtori i Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural z. Vezir Januzi.

z. Vezir Januzi, theksoi, kam përgatitur një informatë të përgjithshme. Pyjet janë pasuri kombëtare dhe nuk është çështje e vetëm e ekonomisë pyjore, e 12 rojeve të pyllit që kujdesen për 30,000 ha pyje sa ka Komuna e Podujevës, por është përgjegjësi e të gjithëve të interesohemi dhe t'i mbrojmë. Një bashkëpunim i mirë i ndërsjellë në mes mekanizmave institucional dhe qytetarëve ka ndikuar në masë të madhe që këto dukuri negative, të shëmtuara në pyje kanë filluar të zvogëlohen. Është me rëndësi të potencohet se nuk kemi burim alternativ të ngrohjes dhe si burim të vetëm kemi vetëm drurin, dhe si rezultat atakohen pyjet në masë të madhe, por DBPZHR është duke u kujdesur dhe mbikëqyrë procesin e pajisjes së qytetarëve me leje përkatëse për prerje të pyjeve dhe mundohemi që pyjet të prehen në mënyrë të kontrolluar. Sigurisht se pyjet do të prehen derisa shteti të gjejë një burim alternativ për ngrohje, por jemi duke punuar që kjo të bëhet në mënyrë kontrolluar. Për fat të mirë këtë vit kemi pas zjarre vetëm në stinën e pranverës së hershme, 11 raste ku kanë përfshirë një sipërfaqe prej 26.10 ha. Mendoj se mekanizmat relevante por edhe qytetarët kanë punuar në këtë drejtim. Kemi një rënie të dëmtimit të pyjeve. Edhe numri i fletëparaqitjeve tregon se ka rënie të prerjes së druve në terren. Deri më tani janë ngritur 235 fletëparaqitje për kundërvajtje, prej tyre 14 si raste penale dhe 221 kundërvajtëse. Në bashkëveprim me Policinë kemi arritur të konfiskojmë një sasi të madhe të druve në terren prej 282.18 m³, sasi kjo, e duke përfshirë edhe atë që është konfiskuar nga viti i kaluar, janë shitur 315 m³ dru përmes Zyrës së Prokurimit, me ç'rast janë inkasuar të hyra buxhetore në shumë 16005.00 €.

z. Nexhmi Rudari, Nënkyetar i Komunës, e hap debatin për këtë pikë të rendit të ditës.

z. Bekim Zogiani, theksoi, situata në gjendjen e pyjeve ka ndryshuar në aspektin pozitiv. Ne si Stacion Policor në takimet që kemi pasur me mekanizmat relevant kemi kërkuar që secili nga këndi i vet të kontribuoj dhe kjo ka rezultuar pozitivisht. Gjatë detyrës po hasim në kamionë dhe traktorë duke bartur masë drunore dhe nuk jemi në dijeni se a posedojnë dokumentacionin përcjellës dhe a janë të shënuara me çekiç, dhe është e nevojshme ta ftojmë inspektorin e pylltarisë, pra kërkesa është që edhe pas orarit të punës të jenë të gatshëm për punë sepse nuk është etike pritja fjala vjen dy orë deri në ardhjen e

inspektorit, kështu që në momentin që kërkojmë prezencën e inspektorit, të arrij sa më shpejtë në vendin e ngjarjes.

z. Qefser Behrami, theksoi, javën që shkoi, patëm një mbledhje të KLSB-së dhe pikërisht u diskutua çështja e personave të pandërgjegjshëm që janë duke dëmtuar pyjet. Mendoj ata që kanë nevojë nuk janë duke bërë dëmtimin e pyjeve por kjo po shkaktohet pikërisht nga ata që nuk kanë nevojë. Sa i përket zjarreve në rajonin tonë nuk ka pasur asnjë rast më të voglin.

z. Vezi Januzi, lidhur me diskutimin e parafolësit dua të shtoj, e potencova më herët se ka kërkesa jashtëzakonisht të mëdha për prerje të pyjeve private. Pronari shpreh interesim për të shitur pyllin dhe blerësi e ekspozon në treg, pra nuk ka mundësi ajo që po mendon parafolësi. Agjencia Pyjore e Kosovës ka nxjerr një vendim që nga viti që vjen personat që vërtetë kanë nevojë gjatë muajit shtator tetor të furnizohen me nga 7-8 m³ dru për nevojat e tyre, e furnizimi do të bëhet përmes Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. Deri sot nga Drejtoria komunale janë lejuar 193 leje për prerje të pyllit, ndërsa prerja bëhet në sasi konformë lejes dhe realizohet me fletë përcjellje dhe damkë pyjore. Nuk mund t'i bëhet ndalesë fjala vjen dikujt nga Prishtina që ka blerë pyll në Komunën e Podujevës, kjo është në kuadër të rregullativës ligjore dhe nuk mund të ndalohet.

z. Qefser Behrami, unë plotësisht pajtoj me parafolësin, por çështja është se sa m³ dru të tjera fshihen pas asaj që figuron në lejen përkatëse. Ne jemi në dijeni edhe për masën drunore të lejuar por edhe për atë të palejuar që është duke ndodhur, fjala është sa ekziston mundësia të ndalen së dëmtuari pyjet për të cilat nuk kanë leje përkatëse, këtu kisha qëllimin dhe për këto raste i kam lajmëruar personat me emër dhe mbiemër.

z. Vezir Januzi, duhet që secili rast i dëmtimit të pyllit të evidentohet dhe të paraqitet, për këtë kam theksuar se është i nevojshëm bashkëpunimi në mes DBPZHR, Policisë dhe qytetarëve, si hallkë e ndërlidhur, sepse një roje pylli është e pamundur të mbrojtë sipërfaqen e pyjeve sa i takon.

z. Nexhmi Rudari, Nënkrjetar i Komunës, nëse nuk ka dikush diçka tjetër për këtë pikë e përmbyll me konstatimin se gjendja në pyje për periudhën raportuese është e përmirësuar, në radhë të parë nga zjarret qoftë të qëllimshme apo të paqëllimshme. Një arsye që u cek këtu se ka më pak prerje ilegale të pyjeve dhe më pak fletëparaqitje, unë konsideroj se mund të jetë edhe për shkak të mungesës së masës drunore në pyje sepse në përgjithësi është dëmtuar shumë në territorin e Kosovës, por është edhe konstatimi i Drejtorit që qytetarët në periudhën e dimrit në Komunën e Podujevës, por jo vetëm, duhet të kenë burim të ngrohjes. Megjithatë neve na shqetëson prerja e druve, por gjithashtu neve si institucion duhet të na shqetësoj paaftësia jonë institucionale për të bërë ripyllëzimin, sepse gjithkund në botë prehen pyjet pas kalimit të afatit të jetëgjatësisë, sepse përndryshe vetë shkatërrohen nga sëmundje të ndryshme të tyre dhe faktorëve natyror. Ne bëjmë prapë apel që edhe me këtë numër të kufizuar që e kemi të rojeve të pyllit por edhe me Policinë Kufitare edhe me Stacionin e Policisë të jemi të gjithë të organizuar, t'i bashkërendojmë veprimet në mënyrë që personat që janë të pajisur me dokumente të mund të punojnë lirshëm, të tjerët qoftë edhe për pyjet private duhet patjetër të pajisen me dokumentacion të lëshuar nga institucioni përkatës. Të gjitha institucionet përkatëse duhet të shkëmbejnë informacione të shpejta dhe të sakta. Nëse nuk keni diçka për të shtuar kalojmë pikën e radhës.

5.Masat parandaluese kundër dukurive negative (përdorimi i narkotikëve, vjedhjet, dhuna etj.)

z. Nexhmi Rudari, Nënkyetar i Komunës, dukuritë negative janë një spektër shumë i gjerë. Konsideroj se me një bashkëpunim të mirë që e kemi pas dhe duhet të vazhdoj në mes të institucioneve arsimore, si Drejtorisë së arsimit me shkollat vartëse dhe Policisë me persona të kualifikuar të vazhdojnë ligjëratat nëpër shkolla, sepse ato ligjëratat kanë pas efektin e vet pozitiv. Nuk po flas vetëm për shkollën, një përdorues i narkotikëve është kriminel potencial sepse ai për të ardhur deri te furnizimi me substanca narkotike duhet të bëjë vepra penale qoftë të grabitjes, vjedhjes, shantazhit etj. Fillimisht fjalën në cilësinë e raportuesit sipas Planit të punës e ka z. Agim Blakçori.

z. Agim Blakçori, ne si DA në kuadër të masave për parandalimin e dukurive negative, ne fokusimin e kemi në fuqizimin e organeve qeverisëse udhëheqëse profesionale të shkollave. Organet e shkollave bashkërendojnë punët dhe aktivitetet për të krijuar një mjedis më të sigurt dhe të shëndetshëm. Kohët e fundit shkollat kanë arritur të formojnë shumë ekipe dhe klube brenda përbrenda shkollës e që kanë ndikim qoftë në shoqërimin e nxënësve mes tyre qoftë edhe drejtpërdrejtë në angazhimin e tyre siç janë p.sh. ka raste të dhunës ku kanë intervenuar dhe kanë arritur t'i ndërmjetësojnë. Fokus tjetër ne si DA dhe shkollat më saktësisht kemi çështjen e përmbajtjes programore, ku një pjesë e këtyre përmbajtjeve ushtrojnë ndikim drejtpërsëdrejti në luftimin e këtyre dukurive negative, sidomos në lëndën e edukatës qytetare etj. , lëndë e cila ka përmbajtje të caktuara që ndikojnë në vetëdijesimin dhe edukimin e nxënësve për rrezikun që mund të paraqesin këto dukuri. Përveç këtyre rol të rëndësishëm luan edhe Këshilli pedagogjik –psikologjik i shkollës, që aktualisht është në disa shkolla dhe varësisht mundësive planifikojmë të zgjerojmë edhe në shkollat tjera. Kemi një bashkëpunim të mirë me Policinë e Kosovës por edhe me organizata të ndryshme në ofrimin e ligjëratave të cilat luajnë një rol të madh në vetëdijesimin e nxënësve. Policia e Kosovës po luan një rol jashtëzakonisht të rëndësishëm me policët e angazhuar pran shkollave ku po arrijnë të identifikojnë personat e dyshimtë, janë duke u ndihmuar Drejtorëve të shkollave por edhe shoqërisë në përgjithësi. Sipas mundësive do të ishte mirë që ky numër i policëve të rritej dhe të jenë prezentë pran çdo shkolle, sidomos këtu në qendër, ku ka prezencë më të madhe. Jemi në dijeni me mundësitë e Policisë por megjithatë kemi vërejtur se është një rol jashtëzakonisht i rëndësishëm në parandalimin e këtyre dukurive. Kemi bashkëpunime të shumta dhe mund t'i quaja të suksesshme edhe me organizata tjera dhe institucione, ku kemi organizuar edhe takime e që do të vazhdojnë edhe në të ardhmen. Në takime gjithashtu ka prezantuar dhe Drejtori i Drejtorisë së Inspeksionit lidhur me inspektimet dhe kontrollat e lokaleve pran shkollave. Në këtë aspekt kemi pasur edhe aksione ku kanë marrë pjesë inspektorë komunal dhe zyrtarë policorë, gjë që kanë ndikuar dhe është një tregues se mbarëvajtja në shkolla është në përcjellje dhe monitorim, uroj që këto të vazhdojnë në funksion të sigurimit të një ambienti më të sigurt.

z. Nexhmi Rudari, Nënkyetar i Komunës, e hap diskutimin për këtë pikë të rendit të ditës.

z. Bekim Zogiani, theksoi, kemi bërë planin për tema të caktuar nëpër shkolla. Ditën e djeshme kemi mbajtur ligjëratat për trafik që u zhvillua për ciklin e klasave të I-V, në teori dhe praktikë. Sipas planit të veprimit, ne që sot do të koordinohemi për ligjëratat në fushën ekstremizmit dhe radikalizmit në kuadër të sigurisë së përgjithshme, janë planifikuar ligjëratat për dhunën në familje, ngacmimet seksuale, përdorimi i narkotikëve dhe dukurive tjera të rrezikshme, këto aktivitete do t'i koordinojmë por gjithherë duke pasur parasysh që mos tu shkaktojmë ngarkesë nxënësve. Kam një kërkesë për Drejtorinë

e Inspeksionit për nevojën e organizimit të kontrolleve më të shpeshta të lokaleve rreth shkollave. Edhe ne si Polici mund të bëjmë kontrolle por nga ne kërkohet një procedurë pak më e gjatë. Inspeksioni ka kompetenca ligjore për të vepruar në këtë aspekt. Në çdo rast nëse nevojitet prezenca apo asistimi i Policisë ne jemi të gatshëm t'i mbështesim në çdo kohë.

z. Nexhmi Rudari, Nënkryetar i Komunës, kemi legjislacionin në fuqi me të cilin shitja e duhanit dhe alkoolit u ndalohet personave nën moshën e caktuar, por po ashtu jemi në dijeni se ka raste të bizneseve afër shkollave ku fëmijëve tanë u shesin cigare me copë, që d.m.th. është krejt e kundërligjshme. Mbi bazën e kësaj me një koordinim të veprimeve të Drejtorisë së Arsimit dhe Drejtorisë së Inspeksionit dhe me mbështetjen e Policisë ne do të mund të fillonim për ndërmarrjen e masave. Besoj se me shqiptimin e 2-3 tiketave bizneseve për shkelje të ligjeve do të vetëdijesoheshin pronarët e atyre bizneseve.

z. Zaim Thaçi, theksoi, kemi marrë pjesë në ligjërata të caktuara në shkolla, mjekët kanë ofruar profesionalizmin e tyre për luftimin e dukurive negative si duhanin, alkoolin, narkotikët etj. Mendoj se ligjëratat për vetëdijesim të nxënësve duhet vazhduar, apo përmes kampanjave të ndryshme. Kur është çështja të trajtimet dhe identifikimet e tyre dua të përmend një detaj, në kolegjiunin e profesionistëve shëndetësor është ngritë kjo çështje ekskluzivisht të punëtorët e QPS të cilët së bashku me policinë janë të involvuar në rastet e tilla. Fjala është për pranimin e punëtorëve profesional që i referohet identifikimit ekskluzivisht të drogave. Deri më tani nuk kemi profesionist për të identifikuar llojin e drogave dhe si rrjedhojë mbetet për tu perfeksionuar QPS, për t'u kompletuar me staf përkatës të kësaj fushe. Megjithatë nga këndvështrimi ynë mendoj se jemi mirë, sikurse e theksoi Nënkryetari më mirë se komunat tjera. Kjo dukuri është një trend në rritje dhe si krahasim rezulton që vendet më të ngritura në aspektin e intelektualizmit të shoqërisë tregojnë shkallë më të lartë të përfshirjes në këto dukuri negative.

z. Faik Muçiqi, theksoi, mendoj se masat parandaluese kundër dukurive negative nuk duhet shikuar ngushtë vetëm në aspektin e shkollave, por duhet më gjerësisht. Me këto dukuri mendoj se duhet të merremi më gjerësisht. Fjala vjen vjedhjet në Komunën tonë janë të ndryshme, si të pushtave, ndriçimit etj, çka do të thotë se janë vjedhje individuale ose grupe të organizuara dhe si rezultat ka fare pak të arrestuar prej tyre. Nëse ne nuk i izolojmë grupet e organizuara kriminale dhe shqiptimin e dënimeve ndaj tyre atëherë kot flasim për arsimimin, edukimin, sepse grupet që i shtynë janë jashtë këtyre aktiviteteve të edukimit.

z. Nexhmi Rudari, Nënkryetar i Komunës, theksoi, vet tema e rendit të ditës është masat parandaluese, ne jemi në dijeni se kemi një fenomen dhe duhet orientuar më shumë te masat parandaluese me të cilat duhet filluar që në moshën rinore fillimisht në shkolla por edhe në institucionet tjera. Mendoj se në këtë temë dhe të ngjashme që janë me rëndësi duhet të jetë e kyçur edhe Bashkësia Islame nëpërmjet ligjëratave tematike që i bëjnë në Xhami. Ky do të ishte mundësi dhe rast i mirë për parandalimin e këtyre dukurive negative që i përmendëm.

z. Bekim Zogiani, sa i përket rasteve të cilat e dëmtojnë shoqërinë tonë në përgjithësi, në periudhën raportuese korrik-shtator 2018 raste ndaj pronës kanë qenë të raportuara 57, ndërsa në periudhën e njëjtë të këtij viti ka një rënie prej 24 raste. Rastet e vjedhjeve të rënda 54 kanë qenë në periudhën e cetur 2018, ka rënie në 33; raste të lëndimeve të lehta –rrahje nga 24 kanë rënë në 19; rastet e lëndimeve të rënda trupore nga 4 kemi vetëm 1 rast; rastet e kanosjes nga 21 kanë rënë në 13; rastet e armëmbajtjes nga 9 kanë rënë në 8 raste; tentim vrasje 1 rast; ndërsa armë të konfiskuara gjatë kësaj periudhe kanë qenë 16

më 2018 dhe 15 në periudhën e njëjtë 2019. Këto rënie janë rezultat i angazhimit të njësive policore në plane të ndryshme operative. Sikurse keni qenë të njoftuar gjatë sezonit veror, konkretisht në kohën kur diaspora ka qenë më e pranishme cak kanë qenë vjedhjet nga veturat e tyre dhe kjo jo vetëm në Podujevë por disa qytete tjera kanë qenë cak i një grupi i cili ka bërë vjedhje nga veturat. Është arritur që përmes dëshmime të arrestohet grupi dhe 11 vepra penale të vjedhjeve janë dokumentuar. Kemi arritur të arrestojmë edhe një person në kryerje të veprës penale ku gjatë asaj nate janë thyer katër lokale dhe i njëjti është arrestuar gjatë thyerjes së lokalit të pestë. Kjo ka ndodhur dy muaj më herët ku janë dokumentuar edhe rastet tjera të mëhershme të vjedhjeve jo vetëm në Podujevë por edhe në Prishtinë. Sigurisht i keni vërejtur dy vetura të djegura para Stacionit të Policisë, ato vetura janë vjedhur në Prishtinë dhe kanë kryer vjedhje me to, pastaj i kanë sjellë në Podujevë dhe i kanë djegur për t'i humbur gjurmët dhe ne përmes punës që kanë zhvilluar Njësia e hetimeve kemi arrit për të dëshmuar se ata persona i kanë vjedhur ato vetura dhe janë kryes të atyre veprave. Gjithashtu tani jemi në zbatim të një Planit operativ nga një Njësi me rroba civile që po patrullon gjatë natës. Sa i përket dukurisë së gjuajtjes me armë nëpër dasma dhe ahengje kjo dukuri është në rënie, kjo duke iu falënderuar edhe Këshillit të Bashkësisë Islame, ku kam kërkuar që gjatë ditëve të premte të kërkojnë edhe nga xhemati që të heqin dorë nga kjo shprehje e cila shpeshherë ka sjellë pasojë fatale. Kjo ka treguar rezultate.

z.Osman Kurtolli, ne si KBI kemi mbajtur takime me përfaqësues të Arsimit dhe Policisë me tema të veçanta të natyrave që u diskutuan më herët. Në këtë kontekst fajtor jemi edhe vet ne sepse edukimi nuk arrihet përmes formës së imponimit, ajo duhet të merret edhe prej dikujt, fjala vjen përmes rrjeteve sociale shohim të gjithë të rriturit kanë alkool përpara, me këtë nuk kam për qëllim për tua ndaluar alkoolin por si rrjedhojë edhe edukata merret aty. Shteti i Kosovës është në tranzicion dhe në këtë periudhë kanë hyrë gjëra për të ciklat mendojmë se janë pozitive por faktikisht nuk janë. Ne duhet të ruajmë traditën tonë kombëtare. Mos respekti jonë reflekton te edukata e fëmijëve tonë, te gjeneratat e ardhshme. Në shtetet perëndimore fjala vjen ne duhet të llogaritim sa shpenzohet kundër dukurisë së narkotikëve, ndërsa në vendin tonë kemi mundësi për të ndaluar që të mos hyjnë fare këto substanca narkotike.

Dua të theksoj se futja e edukatës fetare si lëndë në shkolla sjell vetëm pozitivitet. Mendoj se duhet ende më shumë të punojmë në fushën e edukimit të fëmijëve tonë dhe për eliminimin e dukurive negative.

z. Nexhmi Rudari, Nënkryetar i Komunës, këto çështje na preokupojnë dhe ne duhet të japim kontributin tonë qoftë individual, qoftë institucional. Besoj se sa herë që bisedojmë për çështje të tilla negative nënkupton se jemi duke u marrë me seriozitet, mirëpo nuk mjaftojnë vetëm diskutimet, jam i vetëdijshëm, por sikurse plani operativ duhet pasur aktivitete konkrete. Ne po flasim për prioritetet dhe mendoj se si prioritet i shoqërisë tonë dhe institucioneve është ruajtja e fëmijëve tonë. Ne duhet të punojmë për t'i shmangur fëmijët prej këtyre dukurive, për t'i edukuar si institucion por edhe si familje. Janë edhe institucionet përgjegjëse për edukimin e fëmijëve, por sa po arrijmë për t'i edukuar është çështje tjetër, por gjithherë ka mundësi që të bëhet më shumë nga institucionet përkatëse por edhe nga bashkësitë tjera. Roli i komunitetit në edukim është shumë i fuqishëm, një fuqizim dhe përgjegjësi më e madhe e komunitetit do të jepte shumë më shumë rezultate pozitive. Besoj se askush më shumë se prindërit nuk është i interesuar për edukimin e fëmijës.

Po e përmbyll këtë pikë me këto konstatime që u dhanë por ne duhet të lëvizim përtej këtyre propozimeve dhe rekomandimeve dhe duhet të shohim në mbledhjet e ardhshme të KKSB-së se çfarë kemi bërë ne si institucione, për masat dhe aktivitetet konkrete.

Dukuritë negative shoqërinë e kanë përcjellë gjithherë dhe do ta përcjellin por detyrë jona është që këto ti zvogëlojmë në numër sa më të vogël për t'i mbrojtur fëmijët tanë në radhë të parë dhe qytetarët. Nëse nuk ka dikush diçka rreth kësaj teme kalojmë në pikën e radhës.

5. Të ndryshme

z. Nexhmi Rudari, Nënkyetar i Komunës, sikurse përmendi Komandanti nga dita e djeshme jemi zyrtarisht në fushatë zgjedhore dhe është përgjegjësi e secilit prej nesh që të krijojmë një klimë të mirë, të qetë që kjo fushatë të përfundoj mirë. Kuptohet Policia ka një Plan të veprimit por edhe ne individualisht por edhe si institucion duhet të japim kontributin në mënyrë që fushata zgjedhore të përmbyllet në mënyrën më të mirë të mundshme.

z. Bekim Zogiani, theksoi nga muaji maj kemi filluar me identifikimin e vendeve të rrezikshme në Komunën e Podujevës. Gjatë kësaj periudhe janë identifikuar gjithsejtë 15 lokacione të ndryshme. Besoj që edhe prej Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit do ta kem një informatë për shkak se më datën 05 tetor do të raportoj në Drejtorinë e përgjithshme për lokacionet e identifikuara të rrezikshme dhe masat që janë ndërmarë prej institucioneve lokale.

z. Nexhmi Rudari, Nënkyetar i Komunës, e përmbylli takimin duke i falënderuar të pranishmit për pjesëmarrje dhe kontribut.

Mbledhja përfundoi në orën.11:30

**Procesverbalin e mbajti
Sabedin Namani**

**Nr. 02-060/04-0081050/19
Podujevë, 26 shtator 2019**

**Kryetari i Komunës
Agim Veliu**